

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtarja e vetëm gjykuese, Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni–sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarës M. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1288-6/16 të datës 28.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarës, me datë 21.11.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKTGJYKIM

### E akuzuara:

M. K., nga i ati B. S., e ëma S. e vajzërisë G., e lindur me [ ] në fshatin Z. Komuna e Dragashit, tani jeton në Prizren, rr. [ ], nr. [ ], ka të kryer shkollën mesme, e papunë, e martuar, nënë e një fëmiju, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me nr. personal [ ]

## ËSHTË FAJTORE


Se me datë 25.05.2016, rreth orës 17:00, në udhëkryqin e rrugës “ [ ] ” dhe rrugës së “ [ ] ” përball qendrës Tregtare “ [ ] ”, në Prizren, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 34 dhe 64, të Ligjit për Siguri në Komunakacion Rrugor dhe duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Renault Megane”, me targa të regjistrimit [ ], me ngjyrë të kaltër, gjatë afrimit në kryqëzim duke mos respektuar rregullat e komunikacionit për përparësi kalimi, pa shtuar kujdes të veçantë nuk i jep përparësi mjetit që vjen nga krahu i djathtë i tij, ku me pjesën e përparme të anës së djathtë, e godet në anën e majtë automjetin e markës “Fiat Punto”, me targa 04 [ ] me ngjyrë të zezë të cilën e voziste i dëmtuari R. K. me ç’rast përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pësojnë vozitësi R. K. dhe ate: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e nyjës së shuplakës me dorën e majtë, pasagjeri E. K. dhe ate: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e qafës, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjorë Dr.N. U. të datës 18.08.2016.

**-Këso dore kryen veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KP-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 dhe nenin 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.



Të dëmtuarit: R. (B. ) K. dhe E. K. , që të dy nga fshati H. -e Q. , komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

E akuzuara M. K. , obligohet që t' i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe ate: për ekspertizën mjekoligjore shumë prej 20.00 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 40.88 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m


Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën, PP/II.nr.1288-6/16 të datës 28.10.2016, kundër të akuzuarës M. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së. Pas leximit të aktakuzës prokurori i shtetit Beqë Shala ka bërë përmirësimin e aktakuzës ashtu që edhe në faqen e dytë të saj duhet të figurojë si i dëmtuar edhe E. K. nga fshati H. e Q. , Komuna e Prizrenit.

Në shqyrtimin fillestar e akuzuara M. K. ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara M. K. , me datë 25.05.2016, rreth orës 17:00, në udhëkryqin e rrugës " " dhe rrugës së " " përball qendrës Tregtare " ", në Prizren, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 34 dhe 64, të Ligjit për Siguri në Komunakacion Rrugor dhe duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës "Renault Megane", me targa të regjistrimit " ", me ngjyrë të kaltër, gjatë afrimit në kryqëzim duke mos respektuar rregullat e komunikacionit për përparësi kalimi, pa shtuar kujdes te veçantë nuk i jep përparësi mjetit që vjen nga krahu i djathtë i tij, ku me pjesën e përparme të anës së djathtë, e godet në anën e majtë automjetin e markës "Fiat Punto", me targa " ", me ngjyrë të zezë të cilën e voziste i dëmtuari R. K. , me ç'rast përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pësojnë vozitësi R. K. dhe ate: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e nyjës së shuplakës me dorën e majtë, pasagjeri E. K. dhe ate: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e qafës, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjorë Dr.N. U. , të datës 18.08.2016.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara Mefide Kalanderi, e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se e akuzuara, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e saj, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se e akuzuara prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale të cilat i ka paraqitur përfaqesuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.



Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpall fajtores dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, keqardhjen e shprehur për rastin që ka ndodhur, rrethanat personale- se e njëjta është e martuar, nënë e një fëmiju dhe faktin se kjo është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe në të ardhmen një dënim i tillë do ta parandaloj në kryerjen e veprave penale.

Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.


Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2474/2016, me datë 21.11.2017

Procesmbajtësja

Luljeta Luboteni



Gjyqtarja e vetme gjykuese

Sadije Selmani



**UDHËZIM JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.